



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

PROCESVERBAL

Mbajtur më 02 dhjetor 2019, në mbledhjen e gjashtë (6) të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 10.00

Në mungesë të Kryetarit të Komunës z. Agim Veliu, mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm: z. Bekim Zogiani, Komandant i Stacionit të Policisë; z. Osman Kurtolli, përfaqësues i Këshillit të Bashkësisë Islame; z. Enver Rama, përfaqësues i komunitetit rom; znj. Albina Avdiu, kryesuese e komitetit për Komunitete; znj. Naime Podvorica, zyrtare për Barazi Gjinore; z. Agim Blakçori, drejtor i Drejtorisë së Arsimit; z. Qefser Behrami, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Kërpimëh; z. Nuhi Selimi, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Orllan; z. Rizah Muçolli, kryesues i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi, z. Faik Muçiçi, përfaqësues i emergjencave civile; z. Liman Zeqiri, përfaqësues i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe znj. Donjetë Sheqiri, përfaqësuese e OJQ-ve, mediave lokale, komunitetit të biznesit dhe komunitetit të personave me nevoja të veçanta.

Ndërsa mungoi: z. Naim Bajraktari, kapiten, përfaqësues i FSK-së dhe z. Radisav Perović, përfaqësues i Komunitetit serb.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe: Përfaqësuesi i KFOR-it; z. Liridon Selimi dhe z. Ilir Ademi-FSK; z. Zaim Thaçi, Drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale; z. Bekim Karaxhija – OSBE dhe përfaqësuesit e UNMIK-ut.

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, përshëndetje të gjithëve, pasi që Kryetari i Komunës për shkak të angazhimeve nuk mund të marr pjesë, ne do të fillojmë me mbledhjen e KKSB-së. Në takim kemi prezentë edhe dy përfaqësues të FSK-së të cilët kanë ardhur në vend të z. Naim Bajraktarit, unë ju uroj mirëseardhje. Kam informata se z. Naim Bajraktari më nuk do të jetë përfaqësues i FSK-së në KKSB. Përfaqësuesi i ri duhet të konfirmohet në formë të shkruar nga ana e FSK-së, pastaj kjo sipas rregullit duhet të kalojë në Kuvend për miratim dhe pastaj zyrtarisht kemi anëtarin e FSK në përbërjen e KKSB-së. Materialet konsideroj se i keni marrë të gjithë, a ka ndonjë vërejtje apo plotësim lidhur me rendin e ditës.

Rendi i Ditës

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, theksoi, në kuadër të Rendit të Ditës të jetë edhe një Informatë nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS për

personat e ardhur nga Shqipëria në Komunën tonë pas tërmetit. Informata do të paraqitet nga drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale z. Zaim Thaçi.

Rendi i propozuar i ditës me pikën e propozuar nga Nënkrjetari i Komunës u miratua njëzëri.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 04 nëntor 2019

U miratua njëzëri.

2. Raporti i Policisë së Kosovës për gjendjen e sigurisë në komunë

- Informatë nga përfaqësuesi i KFOR-i për sigurinë në komunë
- Informatë nga përfaqësuesi i FSK-së për sigurinë në komunë

z. Nexhmi Rudari, Nënkrjetar i Komunës, para se të hapim këtë pikë në fakt edhe me Komandantin e Policisë kemi të njëjtin shqetësim sepse jo gjithmonë është çfarë duket në sipërfaqe, nganjëherë duhet të jemi më të kujdesshëm, në veçanti sa i përket çështjes së sigurisë, fjala është për të ardhurit nga Shqipëria, të prekur nga tërmeti, duhet të jemi në dijeni se kush po vjen, cilat janë nevojat e tyre, a është bërë verifikimi i atyre personave. Fatkeqësisht këto situata i shfrytëzojnë edhe persona të pandërgjegjshëm që vijnë me qëllime të caktuara, të cilët përfitojnë nga mikpritja dhe zemërgjerësia dhe nga gjithë ajo çka mund të bëjmë për ta, sepse ne jemi të gatshëm të japim kontributin dhe tua lehtësojmë jetën personave dhe familjeve në nevojë. Fillimisht fjalën e ka Komandanti i Stacionit të Policisë, e pastaj vazhdojmë me informatat që do të japin përfaqësuesi i KFOR-it dhe ai i FSK-së.

z. Bekim Zogiani, sa i përket gjendjes së sigurisë gjatë kësaj periudhe raportuese në muajin nëntor 2019, në përgjithësi kemi një situatë të qetë, mirëpo e ngarkuar me aktivitete të ndryshme. Kemi të evidentuara gjithsejtë 100 raste që krahasuar me periudhën e njëjtë nga viti i kaluar ku kanë qenë 106 raste kemi një rënie të numrit të tyre. Rastet që kanë shënuar rënie dhe që janë më shqetësuese për policinë janë shkaktime të rrezikut të përgjithshëm, i kemi 4 raste të evidentuara që krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit nuk ka pas asnjë rast, të cilat janë kryesisht gjuajtjet me armë. Një rast më shqetësues është sulmi në shtëpinë e një zyrtari policor në fshatin Dumnice, i bërë më datë 28 nëntor në ora 18.30, arsyeja ende nuk dihet, procedura është në vazhdim e sipër. Prej anës policore janë marrë masat për sigurinë e policit dhe të familjes së tij. Sa i përket rasteve tjera më shqetësuese ka qenë numri i aksidenteve, 16 me 6 krahasuar me periudhën e njëjtë të viti të kaluar, 5 persona me lëndime edhe përkundër aktiviteteve gjegjësisht numrit të fletëparaqitjeve, ku janë shqiptuar 868, ndërsa vitin e kaluar 368, në periudhën e njëjtë, dmth një dyfishim, mirëpo prapë ka numër të madh të aksidenteve, e që është një shqetësim bukur i madh për gjithë, jo vetëm për policinë. Kur kam marr informacion për tërmetin në Shqipëri, që është ndier edhe në Kosovë, menjëherë kam kontaktuar Drejtorin e DSHPMSH, Shërbimin e Zjarrfikësve që të koordinohemi dhe të merremi fillimisht me evidentimin se a ka pas ndonjë pasojë, ku fatmirësisht nuk ka pas. Një dukuri tjetër shqetësuese është edhe ardhja e personave ndoshta jo nga zonat e prekura direkt nga tërmeti, por nga zona tjera të cilët e kanë shfrytëzuar situatën për përfitime të ndryshme. Kërkoj nga të gjithë që çdo person që kërkon strehim duhet të shkoj përmes rrugës zyrtare dhe ato të dhëna të na përcillen edhe neve, në mënyrë që të bëjmë evidentimin përmes qendrës në Republikën e Shqipërisë, kështu të dimë saktë numrin e tyre. Zyrtarisht kam informacione për 5 familje të sistemuara në Komunën e

Podujevës, 3 në fshatin Lupç dhe 2 në Podujevë, informacione për të tjera që u përmendën nuk kam pas. Njësitë tona policore gjatë natës kanë hasë persona në një veturë që kanë kërkuar strehim, të cilët kanë qenë pa familje, kështu që duhet pas kujdes sepse po e shfrytëzojnë rastin për qëllime të veta. Kur të largohet një person prej vendit të krizës sikurse kemi rastin në Shqipëri ai merr komplet familjen dhe vjen e kërkon strehim. Sipas informacioneve dyshohet se është një numër i personave me të kaluar kriminale që kanë ardhur, kështu që nëse keni informacione për ata persona të na njoftoni, bashkërisht të bëjmë evidentimin dhe t'i përcjellim tutje në organet shtetërore që janë duke u marrë me trajtimin e kësaj çështjeje.

Përfaqësuesi i KFOR-it, theksoi, siç po raportohet gjendja e sigurisë në Komunën e Podujevës është e qetë dhe stabile. Ju falënderoj për bashkëpunimin që autoritetet lokale e kanë me KFOR-in. Gjithashtu e vlerësojmë dhe çmojmë solidaritetin ndaj Republikës së Shqipërisë për shkak të tërmetit dhe ky është një shembull i mirë që duhet ndjekur.

z. Liridon Selimi, përfaqësuesi i FSK-së, theksoi, FSK do të ndërroj përfaqësuesin në kuadër të KKSBB-së në Komunën e Podujevës për arsye se përfaqësuesi i deritashëm ka kaluar në punë dhe detyra tjera. Ky zëvendësim do të bëhet edhe zyrtarisht. Sa i përket gjendjes së sigurisë në Komunën e Podujevës, në aspektin e përgjithshëm në nivel të Kosovës kemi qenë shumë të angazhuar me ngjarjet e fundit që ndodhën nga tërmeti në Shqipëri, sidomos me pranimin dhe sistemimin e të prekurve nga tërmeti. Çka është shqetësuese sikurse e theksoi edhe Komandanti i Stacionit të Policisë është se ka një numër i konsideruar i personave që kanë ardhur nga zonat që nuk janë prekur nga tërmeti, të cilët kanë shfrytëzuar pikë kalimin kufitar në Gjakovë dhe nga aty kanë ardhur me autobusë. Mirëpo ne kemi marrë masat, kemi kontaktuar me autoritet përgjegjëse të kufirit të Shqipërisë. Ne kemi marrë masat dhe nuk besoj se do të ketë hapësirë për shqetësim.

z. Nexhmi Rudari, Nënkrjetar i Komunës, faleminderit për informatat e paraqitura. Mendoj që në këtë pikë të ndërlidhim edhe informatën e Drejtorit z. Zaim Thaçi. Fjalën e ka Drejtori.

z. Zaim Thaçi, theksoi, ne si DSHMS me marrjen e informatave të para për ardhjen e personave dhe familjeve nga Shqipëria për shkak të tërmetit kemi filluar aktivitetet tona për identifikimin e familjeve, për numrin dhe nevojat e tyre. Nga të dhënat zyrtare rezulton se të ardhurit janë vendosur në 5 lokacione, prej tyre 3 familje në Podujevë, 2 familje në Hotelin Iliria, 1 familje në fshatin Shajkoc, 4 familje në fshatin Lupç i Epërm dhe 3 familje në fshatin Majac, në numër prej 48 anëtarësh, prej tyre 18 janë fëmijë. Jemi munduar për t'i identifikuar kërkesat dhe nevojat e tyre, u kemi bërë kontrolle edhe në aspektin shëndetësor me një ekupe mjekësor. Prej tyre ka pacientë edhe me sëmundje kronike, një prej tyre është edhe insulinë varës, u kemi siguruar mbështetje shëndetësore 24 orësh. Në vizitë te familjet e vendosura në fshatrat Lupç i Epërm dhe Majac kemi identifikuar se ato kanë nevojë edhe për mbështetje materiale, për artikuj themelor ushqimor dhe higjienik. Kemi kontaktuar dhe bashkëpunuar edhe me organizatën Kryqin e Kuq dhe ata janë përgjigjur pozitivisht. Në disa raste disa familje i kanë siguruar strehim por gjithashtu kanë kërkuar edhe për t'i mbështetur materialisht. Për banorët e vendosur në fshatrat Lupç dhe Majac sot iu kemi drejtuar me shkrim Agjencionit të Pyjeve për të na lejuar që t'i furnizojmë me një sasi të masës drusore, të cilën masë e kemi në dispozicion por se lëvizja e tyre nuk mund të bëhet pa ndonjë dokument përcjellës, shpresoj se do të na kthejnë përgjigje gjatë ditës, përkundër asaj nëse brenda ditës nuk e gjejmë ndonjë donator privat për të kryer furnizimin me dru. Nga aspekti social mendoj se deri diku kemi arritur të menaxhojmë situatën.

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, Drejtori përmendi të dhënat e sakta rreth numrit të banorëve të ardhur nga Shqipëria. Do të ishte e nevojshme të formohet një komision dhe zyrtarët nga DSHMS t'i vizitojnë ato familje dhe të marrin të dhënat e tyre personale, pastaj ato të dhëna do i procedonim në qendrën në Prizren apo drejtpërdrejtë në Shqipëri për të bërë verifikimin e tyre. Në kuadër të numrit të banorëve u përmend se 18 janë fëmijë, duhet të kemi informacione të çfarë moshe jenë, cilit nivel të shkollimit i përkasin dhe menjëherë të fillojmë përgatitjet që ata fëmijë t'i integrojmë në procesin e rregullt mësimor nëpër shkolla, sepse nëpër këtë përvojë kemi kaluar vet dhe nuk do të doja që ata fëmijë për periudhën sa qëndrojnë këtu të shkëputen nga procesi mësimor. Do të ishte mirë që menjëherë Drejtori i Drejtorisë së Arsimit të siguroj të dhënat e fëmijëve/nxënësve, e kjo me qëllim që mos t'i lëmë këta fëmijë të shkëputur nga procesi mësimor sepse pastaj pasojat janë më të mëdha. E hapi debatin lidhur me këtë temë.

z. Osman Kurtolli, theksoi, unë vullnetarisht kam pranuar një familje nga Shqipëria. Ajo është një familje prej 3 anëtarëve dhe unë menjëherë i kam lajmëruar në Komunë, mirëpo askush nuk ka ardhur për t'i vizituar, nuk është interesuar askush. Aty janë duke qëndruar 2 gra me një fëmijë i cili është i sëmurë, me terapi të gjatë. Për atë familje jam duke u kujdesur vet. Unë i kam lajmëruar për arsye të se duhet lajmëruar, e jo për ndihmë materiale. Në fshatin Shajkoc i kam të lajmëruara 22 shtëpi në dispozicion për të ardhurit nga Shqipëria. Kam formuar një komision dhe kam konstatuar se prej tyre 8 shtëpi janë të banueshme, ndërsa të tjerat jo. Komisioni komunal duhet të ketë informacione për të ardhurit dhe për nevojat e tyre. Si kryetar i Këshillit të Bashkësisë Islame ndihem shumë keq për situatën në Shqipëri sepse ne jemi vëllezër dhe duhet të reagojmë. Bashkësia Islame në Komunën tonë ka grumbulluar rreth 15,000 € ditën e premte, ndihmë për të prekurit. Ndërmarrja ime ka intervenuar me 11 automjete kombi për dërgimin e ndihmave për të prekurit dhe ato janë dërguar në qendrën e grumbullimit. Përkrahje e madhe është dhënë nga FSK, Policia e Kosovës, nga qytetarët tanë dhe nga subjektet tjera. Pra nga Komuna duhet të vizitohen të ardhurit, të evidentohen dhe familjari të lajmërohet se ka apo nevojë për përkrahje. E përsëris, në shtëpinë time nuk ka qenë askush nga Komuna.

z. Zaim Thaçi, theksoi, unë në fakt drejtpërdrejt kam qenë i kyçur në këtë proces. Për familjen e cila është e strehuar në shtëpinë e z. Osman Kurtolli unë kam informatën, kam qenë në kontakt por nga ajo familje nuk është referuar kërkesë se kanë nevojë për shërbim shëndetësor, përndryshe prej momentit kur ne e kuptojmë se ndokush nga ato familje kanë nevojë për shërbim shëndetësor ne do të veprojmë menjëherë në kuadër të mundësive që i kemi.

z. Osman Kurtolli, theksoi, për familjen që është e vendosur në shtëpinë time kujdesem vet, mirëpo do të ishte mirë dhe e nevojshme që ju si institucion ta vizitoni, me qëllim të evidencës dhe marrjes së shënimeve të drejtpërdrejta dhe të sakta.

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, theksoi, për familjet që kanë shprehur dëshirë për t'i strehuar dhe ndihmuar familjet nga Shqipëria është për çdo lëvdatë, megjithatë duhet të vërehet dora e institucionit, të gjitha familjet duhet vizituar për të parë kushtet e banimit sepse ne duhet të dimë saktë se kush është strehuar dhe kush i ka strehuar. Në këtë rast e shoh një mos koordinim në mes zyrtarëve përgjegjës jo vetëm me këtë por edhe me çështje tjera të natyrës sociale me kryetarët e fshatrave. Secili kryetar i fshatit ku janë të vendosura familje nga Shqipëria do duhej me shkrim të njoftonte Komunën lidhur me numrin e familjeve apo anëtarëve të strehuar në zonën e tyre. Në këtë mënyrë ne do të mund të menaxhonim më mirë situatën dhe t'u dalim në ndihmë dhe të sigurohemi për gjendjen e sigurisë. Fjala vjen nëse një person në ora 24:00 shëtitë me veturë me regjistrim të Republikës së Shqipërisë dhe kërkon strehim, dyshimet janë

shumë të bazuara se ai nuk kërkon strehim por është duke u munduar të shfrytëzojë situatën për kryerjen e ndonjë vepre penale, andaj ne nuk mund të arsyetojmë veten nëse ndodhë diçka. Kryetari mbajti takimin e Shtabit të krizës ku u dhanë orientimet. KKSB pikërisht ka këtë funksion, koordinimin e aktiviteteve në mes akterëve të ndryshëm dhe jo vetëm të sigurisë, por edhe të tjerëve. Po thujse gjithçka e kemi parë edhe trajtuar më herët, madje edhe për ndriçimin kemi theksuar se është indikator i sigurisë, e mos të flasim kur të vijnë persona të jashtëm, sepse nuk do të thotë se të gjithë ata vijnë që kanë nevojë strehimin dhe ofrimin e ndihmës. Të jemi koshient, të marrim masat në mënyrë që mos të na ndodhë ndonjë problem, duhet të jemi syçelë dhe të dimë saktë se kush është në territorin e Komunës, kush janë dhe nga kanë ardhur dhe të bëjmë verifikimin përmes qendrave të autorizuar.

znj. Donjetë Sheqiri, theksoi, sikurse jeni në dijeni më datën 27 kemi marrë një aksion humanitar për solidarizim, për t'i ndihmuar të prekurit nga tërmeti në Shqipëri dhe aty janë lajmëruar familje të shumta të cilat kanë ofruar strehim për familjet e prekura. Mendoj se do të ishte mirë që Komuna të dal me një njoftim që qytetarët që kanë bërë pranimin e familjeve ti lajmërojnë në institucionin kompetent. Këtu u informuam për numrin e të strehuarve në lokalitet e cekura, mirëpo unë po mendoj se numri i tyre është shumë më i madh. Mendoj se qytetarët nuk janë në dijeni se duhet t'i lajmërojnë në Komunë.

z. Faik Muçiqi, theksoi, në takimin e Komitetit Komunal për Mbrojtje dhe Shpëtim kemi trajtuar këtë çështje. Zyrtarët komunal kanë dalë në terren, unë kam një raport edhe pse nuk është i plotë por është i mirë dhe ky duhet t' i shërbejë edhe Policisë dhe për këtë duhet t'i falënderohemi Policisë, Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, Drejtorisë së Shëndetësisë, Drejtorisë së Arsimit por edhe të tjerëve. Besoj ka edhe persona tjerë që kanë ardhur mirëpo edhe pritja ka shkuar në mënyrë individuale. Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale gjatë ditës do t'i sigurojë informatat e nevojshme për të gjithë të ardhurit dhe kjo do t'i përcillet Policisë edhe pse sikurse u përmend secili qytetarë që ka pranuar banorë nga Shqipëria ka për obligim që këtë ta bëj.

znj. Donjetë Sheqiri, në Komunën e Gjakovës përmes organizatave dhe subjekteve kompetente është bërë njoftimi publik për marrjen e të dhënave për secilin person të ardhur nga Shqipëria, kjo ka qenë publike edhe përmes rrjeteve sociale. Do të ishte mirë që ngjashëm të veprojmë edhe në Komunën tonë, sepse jam e sigurt se shumica e qytetarëve të Komunës së Podujevës nuk kanë informata që banorët e ardhur nga Shqipëria duhet regjistruar në institucionin komunal.

z. Liridon Selimi, përfaqësuesi i FSK-së, theksoi, po ndërldhem me parafolësit rreth organizimit të aktiviteteve për grumbullimin e ndihmave, duke u bazuar në atë që jemi përballur ditëve të fundit, mendoj se mundësia më e mirë do të ishte për të bërë centralizimin e ndihmave. Pra brenda Komunës nuk keni nevojë për të bërë grumbullimin e ndihmave, ju kisha sugjeruar që ato të dërgohen në qendrën e grumbullimit në Prizren, sepse atje numri i refugjatëve është shumë i madh, ka kaluar numrin 500 në Qendrën e inovacionit. Përfaqësuesi i Bashkësisë Islame e përmendi se janë 22 shtëpi të lira. Në Prizren na është shfaqur problem sepse edhe pse kanë deklaruar, disa pronarë kanë hezituar t'u bëjnë strehim disa banorëve të komunitetit rom, ashkali, egjiptas etj. Edhe pse një numër i madh është deklaruar për pranimin e të ardhurve, të prekur nga tërmeti, vetëm te një numër i vogël kemi mundur të dërgojmë familjet, kështu që ata që kanë shprehur gatishmërinë për lirim shtëpive duhet t'i njoftoni edhe për këtë dukuri.

z. Nexhmi Rudari, Nënkrjetar i Komunës, mendoj se duhet vlerësuar shumë lartë punën që është bërë në Komunën e Malishevës që kanë strehuar dhe vazhdojnë të strehojnë refugjatë të përkatësive rome nga Republika e Shqipërisë, andaj ne si Komunë

duhet të jemi shumë të vëmendshëm që kushdo që vjen nga Shqipëria, çfarëdo nacionaliteti që janë apo të besimit fetar duhet ndihmuar, sepse nëse ne nuk i shohim njerëzit në aspektin human atëherë edhe ajo e mirë që u bëhet është gjysmake. Ndoshta do të ishte mirë me u takuar me kryetarët e Këshillave të fshatrave, me përcjell këtë mesazh të banorët që donë të ofrojnë strehim. Nëse duam të jemi human atëherë duhet të jemi për të gjithë. Nuk do të doja që kjo të ndodhë në Komunën e Podujevës nëse do të kemi ndonjë rast për strehim.

z. Zaim Thaçi, po flas nga këndvështrimi social. Fondi i subvencioneve në Komunën tonë për vitin 2019 është i shterur. Mundësia jonë që përmes një depoje t'i furnizojmë me artikujt e nevojshëm ushqimor nuk është e mundur sepse ne nuk posedojmë fare një depozitë të tillë. Prej këtij forumi nëse më lejohet kërkoj që familjet që shprehin gatishmëri për ofrimin e strehimit të marrin në konsideratë edhe mbulimin e shpenzimeve të tyre. Ndoshta duket e padrejtë kjo që po theksoj por në fakt ka peshën e vet. Familjet ne strehuara në fshtrat Lupç dhe Majac, pronarët e atyre shtëpive u kanë ofruar vetëm objektin e banimit pa kurrfarë kushtesh tjera dhe ato janë barrë e jona, pra nëse përzgjidhen familjet që kanë shprehur gatishmërinë për lëshimin e objekteve të vijnë në shprehje ato që janë në gjendje t'i mbulojnë të gjitha shpenzimet. Fjala vjen për dy familjet e vendosura në Hotelin "Iliria" nuk kemi kurrfarë obligimesh, përveç vizitës shëndetësore që ua kemi bërë, apo te familja e strehuar në shtëpinë e z. Osman Kurtolli, e që ndoshta edhe kjo është arsyeja pre nuk e kemi vizituar, pasi që janë prononcuar se ata vet i mbulojnë shpenzimet e tyre.

z. Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës, ne çështjen e të zhvendosurve nga Shqipëria mund ta trajtojmë vetëm në aspektin e sigurisë, sepse për çështjet tjera Komuna ka zyrtarët dhe organet përgjegjëse. Ne këtë e ndërlidhëm sepse është vërtetë një gjendje e rëndë për gjithë popullin shqiptar, por është edhe një gjendje që mund të ketë ndikim në sigurinë në Kosovë. Nëse nuk keni çka tjetër kalojmë në pikën e radhës.

3. Informatë për rastet e kthimit dhe integritetit të qytetarëve në shtëpitë (pronat) e tyre.

z. Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës, fjalën e ka z. Liman Zeqiri.

z. Liman Zeqiri, theksoi, procesi i riatdhesimit të qytetarëve të Republikës së Kosovës është fushëveprim i kriterëve themelore ku dihet se pas 28 korrik të vitit 2010 nuk ka më azil. Me shpalljen e pavarësisë së Kosovës njerëzit duhet ta kenë të qartë se nuk ka më azil politik apo ekonomik, mirëpo rrethanat dhe situatat kanë bërë që njerëzit kanë depërtuar në fund të vitit 2014 dhe në fillim të vitit 2015 në mënyrë masive dhe më shumë kanë ikur për çështje ekonomike, sociale etj. Në bazë të dhënave që i kemi, personat që kanë qëndruar në vende të ndryshme të Evropës dhe nuk i kanë plotësuar kushtet për qëndrim janë detyruar të kthehen në vendin e origjinës duke iu referuar edhe marrëveshjeve që kanë lidhur Kosova me shtetet e Evropës për kthimin e tyre. Si rezultat i kësaj Qeveria ka nxjerrë disa rregullore dhe ka formuar mekanizma përkatës për mobilizimin e atyre qytetarëve që ata të orientohen në vendin e origjinës. Si proces është një koordinim i mirë në mes Qeverisë dhe institucioneve lokale. Barrën kryesore e kanë Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Në vazhdim foli për rolin dhe përgjegjësitë e Koordinatorit rajonal, si dhe për përbërjen, aktivitetet dhe fushëveprimin e Komisionit Komunal për Riintegrim, për procesin e shqyrtimit të kërkesave dhe ndihmat e ofruara, trajtimin mjekësor etj. Nënvizoi, secila komunë i ka specifikat e veta dhe këtu si problem më i theksuar del çështja e strehimit apo banimit. Në Komunën tonë nuk kemi ndonjë rast që e kemi në

gjendje të rëndë në kuptimin e strehimit sepse individët më tepër kanë dalë për një jetë më të mirë apo për ndonjë vend pune.

Gjatë vitit 2019 në Komunën tonë janë riatdhesuar 103 persona, prej tyre 60 janë familjarë ndërsa 40 janë kthyer si persona individual. Nga numri i cekur 19 janë nxënës të shkollave fillore dhe të mesme të cilët integrohen në procesin mësimor, sipas procedurave të parapara. Familjet të cilat kanë pas nevojë për ndihmë emergjente 3 familje kanë përfituar strehim të përkohshëm, 2 familje kanë përfitua trajtime mjekësore dhe medikamente përmes Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, 2 familje kanë përfituar pakon dimërore dru zjarri, 3 familje kanë kërkuar që të hynë në skemë sociale. Ne bashkëpunojmë edhe me shumë ojç, sidomos ato ndërkombëtare, duke veçuar ato nga Gjermania, për t'i ndihmuar. Në vazhdim z. Zeqiri foli për format dhe mënyrën e ndihmave të ofruar nga ojç-të dhe institucionet. Nënvizoi, koordinojmë punët edhe me disa Drejtori të Komunës të cilat kontribuojnë dhe luajnë rol të rëndësishëm në këtë fushë.

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, a ka dikush diçka për të shtuar rreth informatës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës.

4. Formimi i Grupit Punues për Planin e Punës 2020

Formimi i Grupit për Informatën për punën e KKSBB për 2019

Nënkyetari pas debatit dhe aprovimit të propozimeve konfirmoi ngritjen e Grupit punues për hartimin e Planit vjetor të punës së KKSBB-së për vitin 2020 dhe për përgatitjen e Informatës për punën e KKSBB për 2019, në përbërje:

- 1.Faik Muçiqi
- 2.Bekim Zogiani
- 3.Osman Kurtolli
- 4.Donjetë Sheqiri
- 3.Agim Blakçori

5. Të ndryshme

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, theksoi, a dikush diçka në pikën të ndryshme.

z. Nuhi Selimi, theksoi, një kompani është duke punuar në shtrirjen e rrjetit kabllor në fshatin Brainë, mirëpo si rrjedhojë një numër i madh i familjeve kanë mbete jashtë rrjetit.

z. Osman Kurtolli, theksoi, ndërmarrja ime është duke punuar në rajonin e cekur nga parafolësi dhe puna që është bërë atje nuk ka të bëjë me Komunën. Ajo është një punë vullnetare që e kemi bërë pas marrjes së lejes nga Komuna. Kemi bërë shtrirjen e rrjetit duke përfshirë edhe disa zona mjaftë të vështira dhe jemi në proces të shpërndarjes.

Nënkyetari përfundoi mbledhjen, ndërsa të pranishmit i falënderoi për pjesëmarrje dhe kontribut

Mbledhja përfundoi në orën 11:10

Procesverbalin e mbajti

Sabedin Namani

Nr. prot. 02-060/04-0091035/19
Podujevë, 02 dhjetor 2019

Kryetari i Komunës
Agim Veliu